



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORT FINAL I TARIFAVE 2022-2024 NH “IBËR LEPENC” sh.a

Procesi Tarifor 2022-2024

dhjetor, 2021

Përmbajtja

Hyrje	5
Baza ligjore	6
Politikat Tarifore.....	6
Procesi i konsultimit për përcaktim të tarifave.....	7
Përbërja e tarifës.....	8
Shpenzimet operative	9
Shpenzimet operative të dorëzuara në aplikacionin e Ibër-Lepenc	9
Shpenzimet operative të aprovuara nga ARRU.....	9
Investimet Kapitale	10
Investimet e dorëzuara në aplikacionin e Ibër-Lepenc.....	10
Investimet Kapitale të aprovuara nga ARRU.....	11
Kthimi i anuitetit të kredisë.....	12
Shitjet e ujit dhe gjatësia e kanalit.....	13
Tarifat e kalkuluara	15
Krahasimi i tarifave historike me tarifat e aprovuara	16

Në këtë raport janë paraqit detajet e procesit të kalkulimit të tarifave të ujit të pa trajtuar me shumicë të NH Ibër Lepenc sh.a. Me këto tarifa NH Ibër Lepenc sh.a do të faturojë konsumatorët KRU "Prishtina" sh.a dhe KUR "Mitrovica" sh.a. përgjatë viteve 2022-2024.

Hyrje

Kanali Ibër, së bashku me digën e Ujmanit, rezervuarin në Pridvoricë dhe një sistem ujitje nën presion me kapacitet të ujitjes së 20,000 ha të tokave bujqësore, u ndërtua në vitet 1970–1980. NH “Ibër-Lepenc” sh.a. me seli në Prishtinë është ndërmarrje shumëfunktionale e cila furnizon industrinë, kompanitë rajonale të ujësjellësit dhe bujqësinë me ujë të papërpunuar si dhe prodhon energji elektrike nga Hidrocentrali i Ujmanit.

Diga e Ujmanit e ndërtuar nga materiali rrethor, me lartësi 107.5 m, u ndërtua në lumin Ibër me një prurje mesatare prej 13.06 m³/s për të krijuar një akumulacion rregullimi shumëvjeçar me kapacitet prej 370 milion m³. Një hidrocentral me madhësi të mesme me një kapacitet të instaluar 33.3 MW i përbërë nga dy turbina 18 m³/s gjeneron energji elektrike në orët e pikut. Hidrocentrali shkarkon ujë në një akumulacion tjetër të vogël rirregullues në Pridvoricë me një kapacitet aktiv prej 480,000 m³. Kanali Ibër devijon ujin nga ky rezervuar përmes një porte që funksionon manualisht.




Figura 1. Harta skematike e Ibër Lepenc-it

Kanali Ibër ka një gjatësi totale prej **49.2 km**, gjysma (24.5 km) është pjesë e hapur e kanalit e mveshur me beton, gjysma tjetër përbëhet nga 11 sifone, 20 akuadukte, 14 tunele dhe tre struktura kontrolli. Me kalimin e kohës, kapaciteti tranzit i Kanalit Ibër ka rënë për shkak të akumulimit të sedimenteve në seksionin hidraulik dhe përkeqësimit të paneleve të betonit. Përmes matjeve të rrjedhës në vend, është vlerësuar se kapaciteti ¹ aktual maksimal është rreth 11 m³/s.

¹ Studimi i fizibilitetit të Bankës Botërore (Water Security and Canal Protection Project)

Baza ligjore

Ligji është specifik në përkufizimin e Furnizuesit të Ujit me Shumicë (FUSH) i cili furnizon ofruesin e shërbimeve të ujit të pijshëm. Ligji përjashton ofrimin e furnizimit të ujit me shumicë për çështje industriale dhe pranuesve tjerë të shërbimeve të tilla. Kështu që politikat tarifore që zhvillon ARRU e përkufizon procesin e vendosjes së tarifave për ujin e ofruar ofruesve të shërbimeve të ujit të pijshëm. Uji me shumicë i cili ofrohet për shfrytëzuesit e tjerë është aktivitet i parregulluar komercial dhe tarifat i nënshtrohen marrëveshjes në mes të palëve të prekura.

Përcaktimi i tarifave të IL-ës është i bazuar në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, publikuar në Gazetën Zyrtare me 14. 01. 2016 për ofruesit e shërbimeve publike të ujit, dhe atë në;

- Nenin 20. paragrafi 3, nën-paragrafi 3.4 mjaftueshmëria e tarifës për të mbuluar shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes të ofruesit të shërbimeve dhe të ndonjë plani të ofruesit të shërbimeve për shpenzime kapitale nëse ato dokumentohen se janë në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të cilat janë miratuar nga autoriteti, dhe
- Paragrafi 3, nën-paragrafi 3.10. tarifa për ujin e papërpunuar e cila merr parasysh shpenzimet e furnizimit të ujit të papërpunuar të ofruesit të shërbimeve përkatëse dhe të një shkallë të përshtatshme të fitimit për furnizuesin e ujit të papërpunuar.

Politikat Tarifore

Pos tjerash, procesi i kalkulimit të tarifave të ujit të pa trajtuar me shumicë, është i detajuar edhe në dokumentacionin tjetër mbështetës të Politikave Tarifore. Kjo Politikë Tarifore zbatohet për furnizimin e ujit me shumicë ndaj ofruesve të licencuar të shërbimeve të ujit të pijshëm. Nuk zbatohet për ujin me shumicë, i cili u sigurohet palëve tjera.

Po ashtu në Politika Tarifore janë dhënë sqarime si më poshtë:

- ARRU duhet të përcaktojë tarifa tre-vjeçare, me rishqyrtimin vjetor intervenues, të përcaktuara me rregullore dhe i kufizuar për rregullimet e inflacionit dhe ngjarje tjera të jashtëzakonshme.
- ARRU ndalon në çfarëdo forme ndër-subvencionimin në mes të sektorëve të ndryshëm që marrin shërbime nga furnizuesi i ujit me shumicë.
- Aplikimi i tarifave uniforme për të gjithë ofruesit e shërbimeve të ujit të pijshëm nuk është i përshtatshëm. Tarifat duhet të vendosen për të reflektuar kostot e furnizimit në pikën e marrjes së ujit në sistemin e furnizuesit të ujit me shumicë.
- Gjatë procesit tarifor apo rishikimit vjetor të tarifave, furnizuesi i ujit me shumicë duhet të ndajë qartë dhe në mënyrë transparente shpenzimet dhe investimet që dedikohen vetëm për dërgimin e ujit me shumicë tek ofruesi i shërbimit. Në bashkërendim me Autoritetin, furnizuesi i ujit me shumicë duhet të kategorizojë dhe ndajë shpenzimet që dedikohen për prodhim të energjisë, ujitjen e tokave, ujin për termoelektrana, etj.

Procesi i konsultimit për përcaktim të tarifave

Departamenti i Tarifave ka hartuar planin kohor për realizimin e procesit tarifor përmes kalendarit tarifor, i cili përcakton afatet kohore dhe bartësit e aktiviteteve. Ky kalendar është miratuar në ARRU pastaj iu është dërguar të gjithë ofrueseve të shërbimeve. Kështu, me datë 1 Mars 2021 ARRU i dërgon ftesë NH “Ibër-Lepenc” sh. a. Prishtinë për aplikim në procesin e ri tarifor 2022-2024, ku janë bashkangjitur dokumentacioni përcjellës me modelin tarifor. Sipas kalendarit tarifor, afati kohor i dorëzimit të aplikacionit ishte me datë 15 prill 2021.

Rrjedha kronologjike kohore e komunikimit në mes të ARRU dhe Ibër-Lepenc është:

- a) Me datë 26 mars 2021 në ambientet e ARRU-së mbahet takim i përbashkët i Departamentit të Tarifave me Ibër Lepencin ku janë dhenë sqarime lidhur me procesin tarifor 2022-2024. Njëherësh, gjatë këtij takimi Ibër Lepenc ka shfaqur problemin e mungesës së planit të shpenzimeve operative për vitet 2022-2024.
- b) Me datë 6 prill 2021 Ibër Lepenc përmes e-mailit ka dërguar informata lidhur me projektin e bankës botërore për sigurimin e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, si dhe kushtet e kredisë së këtij projekti.
- c) Me datë 5 maj 2021 Ibër Lepenc përmes e-mailit ka dërguar formularin për aplikim. Përkitazi me këtë e-mail ARRU i kthen përgjigje prej nga kërkohet që të kompletohet i tërë dokumentacioni sipas ftesës për aplikim tarifor. Ibër Lepenc arsyetohet për vonesë të aplikacionit tarifor me faktin se janë me staf esencial si pasojë e masave pandemike.
- d) Me datë 21 maj 2021 Ibër Lepenc përmes e-mailit dërgon arsyetimet për vonimin e aplikacionit dhe mos kompletimin e dokumentacionit duke thënë se: paqyrat financiare nuk janë kompletuar akoma, mungesa e bordit mbikëqyrës.
- e) Me datë 31 maj 2021, ARRU i dërgon vërejtje përmes e-mailit për tejkalimin e afatit kohor të dorëzimit të aplikacionit tarifor.
- f) Me datë 1 qershor 2021 Ibër Lepenc përmes e-mailit dorëzon aplikacionin tarifor 2022-2024. Në njëjtën ditë ARRU ia konfirmon pranimin e aplikacionit përmes formularit të plotkolluar.
- g) Me datë 3 qershor 2021 pas analizimit të aplikacionit ARRU dërgon Ibër Lepencit komentet lidhur me investimet kapitale, ku kërkohen sqarime plotësuese.
- h) Me datë 12 korrik 2021 në ambientet e ARRU-së mbahet takim i përbashkët i Departamentit të Tarifave me Ibër Lepencin ku është diskutuar për projektin e bakës botërore, investimet kapitale si dhe plotësimi i aplikacionit tarifor.
- i) Me datë 16 korrik 2021 Departamenti i Tarifave mban takim në Ibër Lepenc prej nga përfaqësuesit e ARRU-së kanë ndihmuar Ibër Lepencin në plotësimin e pjesës së investimeve kapitale dhe sasitë e ujit të shitur nëpër pikat shpërndarëse.
- j) Me datë 23 dhe 27 korrik 2021 Departamenti i Tarifave mban takim e radhës në zyrat e Ibër Lepenc prej nga përfaqësuesit e ARRU-së kanë ndihmuar Ibër Lepencin në plotësimin e të dhënave për shpenzimet operative.
- k) Me datë 27 korrik 2021 Ibër Lepenc dërgon të kompletuar aplikacionin tarifor përmes e-mailit.
- l) Me datë 4 nëntor 2021 mbahet takim në mes të IL, ARRU dhe KRU “Prishtina” & “Mitrovica”.

Përbërja e tarifës

Tarifa përcaktohet nga kërkesa për të ardhura pjesëtuar me vëllimin e ujit të shitur. Kërkesa për të ardhura është e përbërë nga dy komponente kryesore:

- Shpenzimet operative
 - Këtu përfshihet edhe projekti i bankës botërore projektin e bankës botërore për sigurimin e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, si dhe kushtet e kredisë së këtij projekti.
- Investimet kapitale

$$t = \frac{k}{Q} \left[\frac{\text{€}}{\text{m}^3} \right]$$

ku:

t - tarifa e ujit të pa trajtuar me shumicë

k - kërkesa për të ardhura (€/vit)

Q - sasia e ujit të shitur (m³/vit)

Përderisa kanali i Ibër Lepenc ofron ujë të pa trajtuar me shumicë përgjatë gjatësisë së tij tek disa konsumatorë, ku janë të përfshirë edhe tre pika marrëse nga KRU-të, është e rëndësishme që të bëhet alokimi i tyre duke marrë për bazë gjatësinë e kanalit si dhe sasinë e ujit që u dërgohet secilit konsumatorë.

ARRU vlerëson se koeficienti i alokimit që merr për bazë gjatësinë e kanalit dhe sasinë e ujit të shitur paraqet njërën prej metodave e cila më së miri do të bënte alokimin e shpenzimeve dhe investimeve për secilin konsumatorë.

Informacione më të detajuara janë të dhëna në modelin softuerik të kalkulimit të tarifës ku për secilën pikë marrëse tregohet gjatësia e kanalit si dhe sasia e ujit të shitur.

Shpenzimet operative

Modeli Tarifor ka të zërthyer shpenzimet operative të NH Ibër-Lepenc në tre kostoqendra, dhe atë:

- Gjenerimi
- Uji me shumicë
- Ujitja

Për secilën prej këtyre kategorive të shpenzimeve operative, ato janë zërthyer edhe më tej, në:

- Rezervuari
- Gjenerimi
- Penda në Pridvoricë
- Kanali për KEK
- Kanali poshtë KEK
- Kanali i ujitjes
- Administrata qendrore

Shpenzimet operative të dorëzuara në aplikacionin e Ibër-Lepenc

Të dhënat për shpenzimet operative në modelin tarifor janë të pasqyruara për 3 vitet e procesit tarifor 2022-2024, si dhe ato të vitit aktual 2021 përfshire dhe historikun e vitit 2020. Në këtë mënyrë është bërë e mundur që të analizohen dhe krahasohen shpenzimet duke marrë bazë të dhënat historike dhe projeksionin për procesin tarifor.

Tabela 1. Shpenzimet operative të Ibër Lepencit në aplikacionin tarifor

Kosto qendra	Njësia	HISTORIKE		PROJEKSIONI		
		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Gjenerimi	€/vit	637,114	637,114	646,671	656,371	666,217
Uji me shumicë	€/vit	1,708,168	1,708,168	1,733,790	1,759,798	1,786,196
Ujitja	€/vit	1,737,532	1,737,532	1,763,595	1,790,049	1,816,900
Totali	€/vit	4,082,814	4,082,814	4,144,056	4,206,218	4,269,313

Në vitin e parë Ibër Lepenc ka paraparë shpenzime prej 4.1 milion euro kurse në vitin e fundit tarifor është parashikuar të ketë rritje prej 4.26 milion euro.

Shpenzimet operative të aprovuara nga ARRU

Përderisa natyra e punës së Ibër Lepenc është komplekse, dhe se ARRU ka për obligim të rregullojë vetëm çështjen e ujit që u dërgohet KRU-ve, sipas tabelës nr.2 mund të vërehet se vetëm pjesa e ujit me shumicë është si komponentë e cila shkon në kalkulimin e tarifës për KRU-të. Si e tillë kjo vlerë, sipas vlerësimit të ARRU-së, është e lartë kur krahasohet me shumën e cila i'u është aprovuar në procesin e kaluar tarifor 2018-2020 e cila ka qenë prej 1.39 milion euro.

Duke qenë se nuk ka pasur ndryshim të theksuar në veprimtarinë e dërgimit të ujit për KRU-të (nuk ka pasur nevojë për rritje të kapacitetit të kanalit, shtimin e ndonjë objekti ndarës, apo ndonjë stacion të ri të pompave si dhe duke vlerësuar se fuqia punëtore do duhej të ishte e njëjtë), ARRU vlerëson se shpenzimet operative që dedikohen për ujin që u dërgohet KRU-ve duhet të jenë të njëjta ose të përafërta me ato të procesit të kaluar tarifor 2018-2020.

Tabela në vijim paraqet shpenzimet e aprovuara nga ARRU për Ibër Lepencin ku tek zëri i ujit me shumicë janë shpenzimet e aprovuara nga ARRU.

Tabela 2. Shpenzimet e aprovuara nga ARRU për vitet 2022-2024

Kosto qendra	Njësia	HISTORIKE		PROJEKSIONET E APROVUARA NGA ARRU		
		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Gjenerimi	€/vit	637,114	637,114	646,671	656,371	666,217
Uji me shumicë	€/vit	1,708,168	1,708,168	1,390,156	1,390,156	1,390,156
Ujitja	€/vit	1,737,532	1,737,532	1,763,595	1,790,049	1,816,900
Totali	€/vit	4,082,814	4,082,814	3,800,422.00	3,836,576.00	3,873,273.00

Investimet Kapitale

Investimet e dorëzuara në aplikacionin e Ibër-Lepenc

Në aplikacionin tarifor Ibër Lepenc ka dorëzuar projeksionet e investimeve kapitale për 3 vitet e procesit tarifor. Vlera e tërësishme e këtyre projekteve prej burimeve vetjake është rreth 3.58 milion €.

Tabela 3. Investimet prej burimeve vetanake të Ibër Lepenc për vitet 2022-2024

Emri i projektit	2022	2023	2024
Ndertimi I objektit administrativ ne Shkabaj	660,000	660,000	660,000
Evakuimi I ujerave te ndotur nga penda e pridvorices	125,000	125,000	0
Mirembajtja dhe renovimi I kanalit kryesor dhe sekondar	280,000	220,000	0
Sanimi dhe renovimi I O.N dhe S.P	200,000	200,000	0
Mirembajtja e L.P 10kV dhe 35 kV	28,500	28,500	0
Sanimi I rreshqitjes se dheut dhe kanalit kryesor Mihaliq-Besi,ne Babin Most	300,000	0	0
Data center(Dhoma e serverave)	95,000	0	0
Gjithsej	1,688,500	1,233,500	660,000

Për secilin investim të listuar në tabelën e mësipërme, Ibër Lepenc ka dorëzuar edhe një dokument përcjellës me arsyetime përkatëse në të cilat janë dhënë informacione mbi paramasën/parallogarinë, arsyetimin e investimit, përshkrimin e tij etj.

Investimet Kapitale të aprovuara nga ARRU

Pas analizimit të të dhënave të përgjithshme të aplikacionit tarifor, në veçanti të atyre për investime kapitale, ARRU ka vlerësuar se shuma e investimeve të planifikuara për vitet 2022-2024 është e lartë dhe disa projekte nuk janë relevante, dhe si të tilla nuk mund të pranohen në tërësinë e tyre.

Përderisa të gjitha investimet e listuara kanë të bëjnë direkt ose indirekt me kanalin kryesor të Ibër Lepenc, si dhe duke ditur se jo e tërë shuma e tyre shkon në kalkulimin e tarifës për KRU-të, kur është analizuar në modelin softuerik vlera e tyre, ka rezultuar se ndikimi i këtyre investimeve është i madh në tarifa për KRU-të.

Andaj, duke pasur parasysh se roli i ARRU-së është të gjejë një balancë në mes të stabiliteti financiar të Ibër Lepencit, dhe përballueshmërinë e tarifave nga KRU-të, në këtë rast si konsumator i tyre, është vlerësuar se shuma e investimeve të dorëzuara në aplikacionin tarifor duhet zvogëluar.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur vetëm totali i investimeve vetanake të pranuar nga ARRU për vitet 2022-2024.

Tabela 4. Shuma e investimeve kapitale vetanake të aprovuara nga ARRU

	2022	2023	2024
Totali i investimeve vetanake të pranuar nga ARRU	278,028	278,028	278,028

Kthimi i anuitetit të kredisë

Kanali i Ibrit është sistem i bartjes së ujit me shumë qëllime i cili furnizon ujin që përdoret për prodhim të energjisë, aktivitete minerare, industri, bujqësi dhe amvisëri. Kosova Qendrore, përfshirë edhe kryeqytetin Prishtinën, varet pothuaj tërësisht nga ky kanal për plotësimin e nevojave të saj për ujë. I ndërtuar në vitet 1970-ta, infrastruktura e kanalit është përkeqësuar me kalimin e viteve. Dëmtimet fizike dhe ndotja, si rezultat i rrëshqitjeve të dheut/ baltës, rrjedhjet nga fermat përreth dhe rrugët, mbeturinat dhe mbetjet e tjera të ngurta, kanë ndikuar në kapacitetin bartës të kanalit, si dhe në cilësinë e ujit.

Ky projekt ka për qëllim kthimin e kanalit kryesor të ujit në Kosovë – Kanalin e Ibrit – në kapacitetin original, që do të sigurojë që furnizimi më i besueshëm me ujë dhe cilësia më e mirë e ujit të sjellë përfitime për rreth 500,000 njerëz që jetojnë në pellgun e kanalit në Kosovën Qendrore ku parashihet edhe ndërtimi i akumulacionit në Mihaliq për raste emergjente.

Projekti do të financohet tërësisht përmes kredisë në vlerë prej 22 milionë eurosh (24.5 milionë USD ekuivalentë) nga Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) i Grupit të Bankës Botërore, që është fond për vendet me nevojat më të mëdha zhvillimore. Kredia për Projektin e Sigurisë së Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit në Kosovë ka një maturitet prej 25 vitesh, përfshirë edhe një periudhë “grace” prej 5 vitesh.

Tabela 5. Komponentët e projektit

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Menaxhimi i projektit	1,500,000.00
2	Punët ndërtimore (përmirësimet në kanalin kryesor)	5,500,000.00
3	Rehabilitimi i kanalit me beton	6,000,000.00
4	SCADA dhe pajisjet elektromekanike	800,000.00
5	Akumulimi i ujit dhe përmirësimet hidraulike	6,900,000.00
6	Renovime në pendën e Ujmanit	300,000.00
7	Shpenzimet tjera të pa-planifikuara	1,000,000.00
Gjithsej		22,000,000.00

Shënim: Pas takimit të mbajtur në ARRU në mes të Ibër Lepenc, dhe KRU-ve respektive, u cek që komponenta e akumulimit të ujit është anuluar, dhe se këto mjete do të ri-destinohen. Megjithatë kësti i kthimit të kredisë dhe të mbetet i njëjtë.

Sipas studimit të fizibilitetit të këtij projekti është vlerësuar se janë 4 deri në 5.5 muaj me reshje që shkaktojnë turbiditet të lartë në FPU të KRU-ve. Me implementimin e këtij projekti benefitet në reduktimin e shpenzimeve vjetore të trajtimit të ujit të KRU-ve, do të jenë sipas tabelës vijuese.

Tabela 6. Përfitimet vjetore mesatare në zvogëlimin e shpenzimeve të trajtimit

Parametrat	Vlera
KRU "Mitrovica" (Njësia Mitrovicë)	186,308
KRU "Mitrovica" (Njësia Vushtri)	65,208
KRU "Prishtina" (Njësia Drenas}	22,357
KRU "Prishtina" (Shkabaj) deri në vitin 2025	130,416
KRU "Prishtina" (Shkabaj) pas vitit 2025	223,570

Anuiteti vjetor përbëhet nga dy këste me nga 363,000.00 €, gjithsej **726,000 €/vit**.

Përderisa ka qenë kusht i Bankës Botërore për të rrit sigurinë e furnizimit me ujë në raste emergjente, përkundër ngarkesës në tarifa ARRU e ka aprovuar koston e anuitetit vjetor të kredisë të këtij projekti.

Shitjet e ujit dhe gjatësia e kanalit

Përgjatë kanalit të Ibër Lepencit janë disa pika në të cilat distribuohet uji me shumicë i pa-trajtuar, ku bëjnë pjesë Kompanitë Rajonale të Ujësjesit, Ferronikeli, KEK-u dhe uji për ujitjen e tokave bujqësore.

Subjekt i rregullimit të ARRU-së është vetëm sasia e ujit që u dërgohet KRU-ve, por përderisa ky kanal përdoret edhe për veprimtari të tjera biznesore të Ibër Lepencit, është me rëndësi që shpenzimet dhe investimet që bëhen në këtë kanal të ndahen proporcionalisht në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër metodat e cila më së miri do të bënte alokimin e shpenzimeve dhe investimeve është metodologjia e cila merr për bazë sasinë e ujit që u jepet një konsumatori përgjatë një kanali dhe në cilën distancë. Pra, nëse një konsumator ka gjatësi të shkurtë të kanalit, doemos që alokimi i shpenzimeve për të do të ishte më i vogël, edhe për konsumatorin tjetër nëse ka gjatësi të gjatë të kanalit rrjedhimisht do të ngarkohej me më shumë shpenzime operative e investime kapitale. Dhe kjo metodikë e alokimit të shpenzimeve dhe investimeve merr për bazë edhe sasinë e ujit që merr secilin konsumator prej nga fitohet komponenta "km x m³" ku pastaj në bazë të saj fitohet përqindja e pjesëmarrjes së shpenzimeve e investimeve për secilin konsumator.

Kjo metodologji është paraqitur përmes dy tabelave ku janë kalkuluar përqindjet e alokimit.

Tabela 7. Konsumi vjetor i ujit sipas pikave marrëse përgjatë kanalit të Ibër-Lepencit

Konsumatori	km	Konsumi vjetor i ujit në m ³		
		2022	2023	2024
Shipol - Mitrovicë (KRU "Mitrovica)	17.5	22,618,704	23,071,078	23,532,500
Balinc - Vushtri (KRU "Mitrovica)	25.0	6,433,344	6,562,011	6,693,251
Bivolak - Prishtinë (KRU "Prishtina)	45.8	3,375,105	3,442,607	3,511,459
Shkabaj - Prishtinë (KRU "Prishtina)	40.2	15,801,024	16,117,044	16,439,385
Ferro-Nikel	45.8	2,008,961	2,049,141	2,090,123
KEK	49.0	13,072,147	13,202,869	13,334,897
Ujitja	44.9	4,550,000	4,712,500	4,875,000
Gjithsej	n/a	67,859,285	69,157,250	70,476,615

Pas shumëzimit të vlerave për gjatësi dhe sasi fitohet një vlerë për secilën pikë marrëse. Kur vlerat për secilën pikë marrëse vendosen në raport me totalin e tyre atëherë fitohen koeficientet përkatës të cilët janë të paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 8. Alokimi i kërkesës për të ardhura për konsumatorët e kanalit

Konsumatori	Alokimi i përqindjes në kërkesën për të ardhura		
	2022	2023	2024
Shipol - Mitrovicë (KRU "Mitrovica)	17.69%	17.74%	17.78%
Balinc - Vushtri (KRU "Mitrovica)	7.19%	7.21%	7.22%
Bivolak - Prishtinë (KRU "Prishtina)	6.91%	6.93%	6.94%
Shkabaj - Prishtinë (KRU "Prishtina)	28.39%	28.46%	28.53%
Ferro-Nikel	4.11%	4.12%	4.13%
KEK	28.63%	28.42%	28.2%
Ujitja	7.07%	7.12%	7.20%
Gjithsej	100%	100%	100%

Nga tabela e mësipërme vërehet se KRU Mitrovica dhe KRU "Prishtina" kanë nga dy pika marrëse të ujit. Pas kalkulimeve del se alokimi për KRU Mitrovica dhe KRU "Prishtina" përgjatë viteve të procesit tarifor është si në tabelën nr.9.

Tabela 9. Alokimi i kërkesës për KRU "Mitrovica" dhe KRU "Prishtina"

Konsumatori	Alokimi i përqindjes në kërkesën për të ardhura		
	2022	2023	2024
KRU "Mitrovica"	24.88%	24.94%	25.00%
KRU "Prishtina"	35.30%	35.39%	35.47%
Totali i KRU-ve	60.18%	60.33%	60.47%

Tarifat e kalkuluara

Tarifat për KRU-të fitohen kur pjesëtohet kërkesa për të hyra me sasinë e ujit të shitur. Fillimisht është paraqitur kërkesa për të hyra tek kanali i Ibër Lepenc, pastaj ajo është alokuar me koeficientin përkatës tek KRU “Mitrovica” dhe KRU “Prishtina”.

Tabela 10. Komponentët e kërkesës për të hyra për kanalin e Ibër Lepencit

Kërkesa për të hyra	Aplikacioni nga NH Ibër Lepenc			Aprovimi nga ARRU		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Shpenzimet operative	1,733,790	1,759,798	1,786,196	1,390,153	1,390,152	1,390,159
Investimet Kapitale	1,688,500	1,233,500	660,000	278,028	278,028	278,028
Kthimi i anuitetit	726,000	726,000	726,000	726,000	726,000	726,000
Gjithsej	4,148,290	3,719,298	3,172,196	2,394,181	2,394,180	2,394,187

Tabelat vijuese bëjnë kalkulimin e saktë të tarifës për secilën KRU, duke marrë për bazë koeficientin e alokimit të fituar përmes metodës “kilometër dhe sasi e ujit të shitur”.

Tabela 11. Tarifat e kalkuluara për KRU “Mitrovica”

	Aplikacioni nga NH Ibër Lepenc			Aprovimi nga ARRU		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Koeficienti i alokimit	24.88%	24.94%	25.00%	24.88%	24.94%	25.00%
Kërkesa për të hyra	818,182	713,226	628,031	595,712	597,207	598,530
Shpenzimet operative	431,396	438,966	446,536	345,893	346,761	347,530
Investimet kapitale	206,145	93,166	-	69,178	69,352	69,505
Kthimi i kredise	180,641	181,094	181,495	180,641	181,094	181,495
Sasia e ujit të shitur (m ³)	29,052,048	29,633,089	30,225,751	29,052,048	29,633,089	30,225,751
Tarifa e kalkuluar (€/m ³)	0.0282	0.0241	0.0208	0.0205	0.0202	0.0198
Tarifa e mesatare e ponderuar 3 vite (€/m ³)	0.0243			0.0201		

Kërkesa për të hyra përbëhet nga tri komponentë (shpenzimet operative, investimet kapitale dhe kthimi i kredisë) të cilat mesatarisht kapin totalin prej 597,150 €/vit, kurse sasia e ujit të shitur është mesatarisht në vlera prej 30 milion m³/vit. Pas kalkulimit të këtyre dy komponentëve fitohet tarifa e ponderuar për KRU “Mitrovica” e cila do të jetë e apliukueshme për vitet 2022-2024 në vlerë prej 0.0201 €/m³.

Tabela 12. Tarifat e kalkuluara për KRU "Prishtina"

	Aplikacioni nga NH Ibër Lepenc			Aprovimi nga ARRU		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Koeficienti i alokimit	35.30%	35.39%	35.47%	35.30%	35.39%	35.47%
Kërkesa për të hyra	1,160,823	1,011,913	891,040	845,187	847,307	849,184
Shpenzimet operative	612,057	622,797	633,538	490,748	491,978	493,070
Investimet kapitale	292,475	132,183	0	98,149	98,395	98,613
Kthimi i kredise	256,290	256,933	257,502	256,290	256,933	257,502
Sasia e ujit të shitur (m ³)	19,176,129	19,559,651	19,950,844	19,176,129	19,559,651	19,950,844
Tarifa e kalkuluar (€/m ³)	0.0605	0.0517	0.0447	0.0441	0.0433	0.0426
Tarifa e mesatare e ponderuar 3 vite (€/m ³)	0.0522			0.0433		

Kërkesa për të hyra përbëhet nga tri komponentë (shpenzimet operative, investimet kapitale dhe kthimi i kredisë) të cilat mesatarisht kapin totalin prej 847,226 €/vit, kurse sasia e ujit të shitur është mesatarisht në vlera prej 19.5 milion m³/vit. Pas kalkulimit të këtyre dy komponentëve fitohet tarifa e ponderuar për KRU "Prishtina" e cila do të jetë e apliukueshme për vitet 2022-2024 në vlerë prej 0.0433 €/m³.

Krahasimi i tarifave historike me tarifat e aprovuara

Gjatë procesit të kaluar tarifor 2018-2020 për KRU "Mitrovica" dhe KRU "Prishtina" janë përcaktuar tarifat sipas tabelës vijuese, të cilat kanë qenë të njëjta për gjatë procesit tarifor. Në rrethanat e shkaktuara nga pandemia COVID-19, tarifat e vitit 2021 janë caktuar të njëjta me ato të vitit paraprak.

Për vitet 2022-2024 për KRU "Mitrovica" tarifat do të jenë 0.0201 €/ m³ kurse për KRU "Prishtina" do të jenë 0.0433 m³.

Siç vërehet tek të dyja KRU-të do të ketë ngritje të tarifave dhe kjo ngritje bazohet vetëm me rritjen e kërkesës për të hyra si pasojë e kthimit të kredisë për projektin e Bankës Botërore.

Tabela 13. Tarifat historike të NH Ibër Lepenc për KRU "Mitrovica" dhe KRU "Prishtina" si dhe ato të aprovuara nga ARRU për vitet 2022-2024

Konsumatori	Njësia	2020	2021	2022	2023	2024
KRU "Mitrovica"	€/m ³	0.0163	0.0163	0.0201	0.0201	0.0201
KRU "Prishtina"	€/m ³	0.0364	0.0364	0.0433	0.0433	0.0433